



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.974/22

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Firma Pastruese “Krasniqi Shpk” me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson T.I, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1158/16 të datës 18.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.12.2023, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1158/16 të datës 18.11.2020, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1158/16 të datës 18.11.2020, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Firma Pastruese “Krasniqi Shpk” me seli në Prishtinë, Rr. “Isa Boletini”, Ulpianë, P+8/2, nr.47 dhe Anulohet vendimi i të paditurës PSH nr.209/16 i datës

29.07.2016. Nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, është obliguar e paditura që paditësit Firma Pastruese “Krasniqi Shpk” me seli në Prishtinë t’ia kthej mjetet monetare në lartësi prej 5,000.00€ (pesëmijë euro) në emër të depozitës për sigurimin e ankesës si dhe kamatën ligjore në lartësi prej 8% nga dita kur është bërë pagesa e depozitës për sigurimin e ankesës e deri në kthimin e të njëjtës. Nën pikën III të dispozitivit të aktgjykimit ky aktgjykim zëvendëson aktet e nuluara. Ndërsa, nën pikën IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë e paditura Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë, përmes A.B., Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të Dhoma e Shkallës së Dytë ta anuloj aktgjykimin e Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative A.nr. 1158/16 i datës 18.11.2020 i protokoluara nga OSHP me datën 23.11.2020, si të pa bazuar dhe njëherit ta kthej lëndën për rishqyrtim tek organi i shkallës së parë, sepse i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me nenin 99 pika 1, 2 dhe 3 dhe nenit 119 pika 1,2 dhe 3 të LPP-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar të Organit Shqyrtues të Prokurimit, PSH nr.209/16 i datës 29.07.2016, nën pikën I të dispozitivit të vendimit, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e OE “Krasniqi Shpk” –Prishtinë me nr. 209/16, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull, “Pastrimi i hapësirave të brendshme të QKUK-së” me nr. prot. 701-16-076-211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “Qendra Klinike dhe Universitare e Kosovës”-(QKUK). Nën pikën II të dispozitivit të vendimit, Autorizohet, autoriteti Kontraktues/Qendra Klinike Universitare e Kosovës/ që për aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i hapësirave të brendshme të QKUK-së”, me nr. prok. 701/16/067/211, të vazhdoj me procedura të mëtutjeshme për aktivitet të prokurimit dhe të vazhdojë afatin për dorëzim të ofertave konform LPP-së. Nën pikën III. Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues janë të pa qëndrueshme, i konfiskohet sigurimi i ankesës. Nën pikën IV të dispozitivit të vendimit,

Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 03.08.2016, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të paditurës dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar duke e anuluar vendimin lartcekur. Me arsyetim se gjykata vërtetoi pretendimin ankimor të paditësit në lidhje me kërkesat e autoritetit kontraktues në rastin e aktivitetit të Prokurimit “Pastrim i hapësirave të brendshme të QKUK-së me nr.prot. 701-16-076-211, janë jo ligjore dhe për të njëjtat erdhi në përfundim se e paditura kishte shkelur nenin 7 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Gjykata gjeti se obligueshmëria e operatorëve ekonomik nga ana e Autoritetit Kontraktues (QKUK), që Operatorët Ekonomik duhet të kenë në pronësi stabilimente apo pajisje teknike të caktuara, të cilat madje edhe i ka specifikuar në dosjen e tenderit, janë kritere diskriminuese për të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës apo potencialisht pjesëmarrës në këtë aktivitet prokurimi, por edhe për Operatorët Ekonomik të cilëve ju është mohuar pjesëmarrja në tender për shkak të kriterëve diskriminuese të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues, në këtë rast QKUK. Në këtë kuptim gjykata gjeti se kushtëzimi i të pasurit në pronësi pajisje apo stabilimente të ndryshme teknike nga ana e Operatorit Ekonomik e shpërfaq elementin diskriminues dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë bie në kundërshtim me nenin 69 paragrafin 4, nën paragrafin 4.5 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili në mënyrë të qartë e shpjegon mundësinë që autoriteti kontraktues të kërkoj të dhëna me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve, ku në nën paragrafin 4.5 thuhet: *“4.5 raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimeve”*. Në pikëpamje të gjykatës dhe sipas interpretimit të saj, është e qartë se këtu bëhet fjalë për termin “në dispozicion” e në asnjë rrethanë nuk paragjykohet e as nuk përcaktohet termi “pronësi”, për çka i lihet mundësia Operatorit Ekonomik të ofroj shërbimet e kontraktuara me mjetet apo stabilimentet teknike që mund ti ketë në pronësi, mund ti marr me qira apo që në çfarëdo rruge ligjore mund ti siguroj ato dhe ti vë në shërbim në punën e saj të kontraktuar. Gjykata hodhi poshtë pretendimet e përfaqësuesit të paditurës se paditësi ishte shpallur i pa përgjegjshëm, duke marr parasysh faktin

se ankesa e paditësit, në atë kohë Operator Ekonomik kishte të bënte vetëm me kriteret në bazë të cilave planifikohej të zhvillohej ai aktivitet i prokurimit dhe se paditësi nuk i ishte nënshtruar asnjëherë procedurës së tenderimit apo të vlerësimit të ofertës së tij nga ana e Autoritetit Kontraktues, me çka rrjedhimisht, cilësimi i paditësit si i papërgjegjshëm nga e paditura është në shpërputhje të plotë me ligjin për Prokurimin Publik dhe fazën të cilën e ka ndjekur paditësi. Këto pretendime, gjykata vërtetoi edhe deklaratën e dëshmitarit në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 13.11.2020, ku ndër tjerash dëshmitari A.Sh. deklaroi se “ në bazë të analizave dhe konstatimeve që kam vlerësuar, kam hartuar një raport ku ka rezultuar me rekomandime për Autoritetin Kontraktues që të bëjë korrigjimet e nevojshme në Dosjet e Tenderit për arsye se ato kërkesa nga ana ime janë konsideruar kërkesa diskriminuese dhe njëkohësisht kërkesat e tilla kanë minimizuar konkurrencën e lirë. Rekomandimi i ekspertit ka qenë që autoriteti kontraktues të modifikoj respektivisht ndryshoj kërkesat në dosjen e tenderit që lidhen me kualifikimin e Operatorëve Ekonomik, për arsye se ato kërkesa nga na ime janë konsideruar kërkesa diskriminuese, pra thjeshtë kërkesat të cilat e minimizojnë konkurrencën çka do të thotë se minimizimi i kërkesës kualifikuese e dëmton financiarisht Autoritetin Kontraktues, sepse rezulton me reduktim të Operatorëve Ekonomik të cilët mund të ofertojnë, përndryshe më konkretisht janë të pasqyruar sqarime me ekspertizën datës 22.07.2016. Gjykata mori në konsideratë të gjitha pretendimet tjera të përfaqësuesit të paditurës dhe për të njëjtat erdhi në përfundim se janë të pa argumentuara, të paligjshme dhe të pambështetura në fakte apo në të drejtën materiale.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar provat dhe pretendimet e paditësit lidhur me kërkesëpadinë e tij, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Përkundër se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, kolegji i kësaj gjykate të njëjtin e ka shikuar sipas detyrës zyrtare sa i përket kësaj baze ankimore, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar

seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës në ankesë për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që vendimmarrja për rastin në fjalë është marr kryesisht nga deklarata e ekspertit të OSHP-së, i cili nuk ka deklaruar asgjë tjetër përveç atyre që ka sqaruar raportin në ekspertizë të datës 22.07.2016 ku ka qenë i autorizuar nga OSHP për të shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues. OSHP konstaton se gjykata është thirrur që të merr në shqyrtim të gjitha faktet dhe provat e prezantuar të analizoj mirë arsyeshmërinë e vendimmarrjes në rastin konkret të dhënë nga OSHP dhe të nxjerr një vendim objektiv dhe jo ti falet besimi personit të caktuar. Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, meqë gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se e paditura nuk ka arsyetuar fare pretendimet e paditësit por vetëm ka përshtuar kronologjinë e ngjarjes, po ashtu e paditura gabimisht i është referuar dispozitave të LPP-së dhe gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, pasi që në nenin 69 paragrafi 5 i referohet vetëm mundësisë së inspektimit gjë e cila nuk ka prova të jetë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues e as nga e paditura. gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se e paditura nuk ka dëshmuar as përmes përgjigjes në padi dhe as në seancën e shqyrtimit kryesor pretendimet e tyre gjatë shqyrtimit të ankesës së paditësit. Gjykata ka konstatuar se nuk është provuar ndryshe nga e paditura në asnjë fazë të procedurës të këtij konflikti administrativ. Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka anuluar vendimin e të paditurës, duke e obliguar të njëjtën që paditësit t'ia kthej mjetet monetare në lartësi prej 5,000.00€ në emër të depozitës për sigurimin e ankesës si dhe kamatën ligjore në lartësi prej 8% nga dita kur është bërë pagesa e depozitës për sigurimin e ankesës e deri në kthimin e të njëjtës. Prandaj, në një gjendje të tillë të vlerësimit, sipas bindjes edhe të kolegjit të kësaj gjykate e bënë të pa qëndrueshëm arsyetimin e vendimit kontestues. Ngase në arsyetim të vendimit të kontestuar është dashur të vlerësohen pretendimet e paditësit që kanë rëndësi vendimtare në mënyrë që të jepen sqarime bindëse.

Kurse, sa i përket pretendimeve tjera ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vlerësuar provat e administruara, dhe po ashtu gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës OSHP, kur ka marrë vendimin mbi aprovimin e padisë së paditësit. Kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se janë të pa bazuara dhe të pa ndikim në vërtetimin

e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë, për shkak se vendimi i kontestuar i të paditurës përmban të meta të tilla esenciale të lartcekura që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së tij. Andaj, aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, për shkak se gjykata e shkallës së parë gabimisht vlerësoi provat e administruara po ashtu gabimisht aplikoi edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, Ky kolegji këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara me prova konkrete, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditurit.

Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

K.DH.SH.II.nr.974/22, me datë 15.12.2023

**Kryetare e kolegjit,  
Saranda Bogaj Sheremeti**